

L I G J
Nr. 8650, datë 28.7.2000

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8114, DATË 28.3.1996, “PËR
SPORTIN”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8114, datë 28.3.1996 “Për sportin” bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 1 pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“Organizatat sportive vendore janë klubet ose/dhe shoqatat sportive, që zhvillojnë veprimtarinë e tyre sportive në një bashki ose komunë të Republikës së Shqipërisë.”

Neni 2

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

“Shteti ka për detyrë të nxisë zhvillimin e sportit për të gjithë dhe ndërtimin e mirëmbajtjen e infrastrukturës sportive.

Shteti financo veprimtaritë sportive të organizatave sportive kombëtare dhe krijon lehtësira fiskale për veprimtarinë ekonomike të tyre, në përputhje me ligjin.

Shteti financo veprimtarinë sportive të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), të federatave sportive dhe klubeve sportive, nëpërmjet financimit të projekteve të paraqitura prej tyre, brenda fondeve buxhetore të miratuara me ligj dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për Ministrinë Përgjegjëse për Sportin.

Financimi buxhetor i organizatave sportive zbatohet vetëm sipas kritereve të përcaktuara nga Ministri i Financave dhe Ministri Përgjegjës për Sportin.

Neni 3

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Klubi sportiv ndërtohet dhe funksionon si shoqatë ose si shoqëri tregtare.

Klubi ose shoqata sportive ndërtohet dhe funksionon si shoqatë sportive në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

Klubi sportiv ndërtohet dhe funksionon si shoqëri tregtare në përputhje me legjislacionin për shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë.

Klubi sportiv mund të transformohet nga shoqatë sportive në shoqëri tregtare vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të tij, në përputhje me aktet nënligjore të Ministrisë Përgjegjëse për Sportin.

Vetëm klubet sportive që funksionojnë si shoqëri tregtare kanë të drejtë të kenë si qëllim fitimin në veprimtarinë e tyre sportive.

Një shoqatë sportive ka të drejtë të jetë ortak në krijimin e një shoqërie. Shoqëria e krijuar me ortak me një shoqatë sportive, quhet shoqëri sportive mikse dhe regjistrohet në federatën përkatëse. Pjesa e fitimit e shoqatës si ortak në shoqërinë sportive mikse investohet përsëri në veprimtarinë sportive të shoqërisë.

Kur shoqëria tregtare sportive mikse merr emrin e shoqatës sportive që hyn si ortak, ky emër mbetet pronë e shoqatës sportive në rastin e shpërbërjes së shoqërisë ose të daljes së shoqatës nga

shoqëria tregtare.”

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2721, datë 3.8.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.